



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
FIER

NJOFTIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR POZICIONIN E PUNËS NJË VEND

“Mirembajtes godine ”

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Fier, kërkon të punësojë në pozicionin **1 (një) punonjës në administratë me detyrë "Mirembajtes godine "(me kontrate 6 ore).**

Bazuar në nr. 97/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"

NJOFTON:

Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **I (një) vend "Mirembajtes godine " me kohe te pjeshme (6 ore ne dite) me periudhe kohore deri ne daten 31/12/2023 ne** Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Fier .

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë apo mos të ketë qënë nën hetim;
- Të mos jete ndjekje penale.
- Te kete mbruar shkollen e mesme.
- Të kenë përvojë prej të paktën një viti të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale ne institucione shtetore .

2. Kushtet e posaçme:

- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale si dhe sjellje etike.

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të përgjithshëm Fier këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së mesme, certifikatë notash dhe çdo dokument tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje te librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim vendbanimi.
- i) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.
- j) Referenca të mundshme nga punëdhënësi të mëparshëm.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier , deri në datën 18.09.2023 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 0342223, ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al.

